

E HËNË DATA 13 SHKURT 2023

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

Kryetare, unë si nënkryetare e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, në emër të grave deputete të Partisë Socialiste, si dhe ministreve të kabinetit qeveritar, sot kam depozituar në Kuvendin e Shqipërisë një deklaratë lidhur me gjuhën e patolerueshme të përdorur nga deputeti Sali Berisha. Ne kërkojmë që organet kompetente të Kuvendit të fillojnë menjëherë procedurat për marrjen e masës disiplinore të përjashtimit të deputetit Sali Berisha nga seancat e Kuvendit të Shqipërisë në afatin maksimal të lejuar nga Rregullorja, dhe njoftojmë Kuvendin e publikun e gjerë... (Zhurmë bilbili në sallë.) Më poshtë lexojmë deklaratën e firmosur nga 27 deputetë: “Deputeti Sali Berisha ka arritur së fundmi një kulm të patolerueshëm, në kapërcim të çdo kufiri etik, përmes një agresioni vulgar që ka cenuar rëndë jo thjesht dinjitetin e ministreve, por edhe të deputeteve të shumicës dhe të vetë Kuvendit të Shqipërisë. Ky agresion, i kryqëzuar me fantazitë monstruoze të videove komprometuese ndaj të gjithë të lartpërmendurve, që deputeti Sali Berisha ka thënë publikisht se i ka, por nuk do t’i bëjë publike, s’ka asnjë mundësi të lihet të kalojë, si shumë të tjera të gjuhës së tij më parë.

3Në Kodin e Sjelljes së Deputetit, ndër të tjera, thuhet se deputeti duhet të reflektojë integritet individual dhe institucional dhe të shmangë çdo diskriminim për shkak të gjinisë, bindjeve politike apo të çdo natyre tjetër. Ndërkohë, deputeti Sali Berisha ka kohë që jo vetëm nuk reflekton asnjë integritet individual dhe institucional, jo vetëm nuk shmang asnjë diskriminim për shkak të gjinisë e të bindjeve politike, por ka marrë edhe statusin e dikujt që mund të nxjerrë nga goja çdolloj ultësie gjuhësore, pa u përballur me asnjë konsekuencë. Ne kemi bindjen se deputeti Sali Berisha nuk duhet lejuar të marrë pjesë në seancat e Kuvendit nëse nuk bën njërën nga këto të dyja: ose të nxjerrë provat, që mbështesin përdaljen ekstreme të gjuhës së tij ditët e fundit, ose t’u kërkojë falje publike subjekteve të dhunës së shfrenuar. Kjo deklaratë bëhet referuar nenit 3 të Kodit të Sjelljes së Deputetit, i cili parashikon parimet e përgjithshme të sjelljes së deputetit gjatë ushtrimit të mandatit dhe aplikohet për çdo veprimtari të deputetit, jo vetëm në Kuvend. Sanksionet e Rregullores dhe Kodit të Sjelljes për çështjet që ngrihen në këtë kërkesë lidhen me shkeljet e veprimtarisë së Kuvendit. (Zhurmë bilbili në sallë.) Për sa më sipër, kërkojmë që organet kompetente të Kuvendit të Shqipërisë të marrin masa të menjëhershme”. Kjo deklaratë, e firmosur nga 27 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, është depozituar sot (kjo është një pjesë e deklaratës), kështu që kërkojmë të shqyrtohet menjëherë. Faleminderit!